



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



Prishtinë, 23 mars 2023

Kodi i ZRRE-së: V\_1709\_2023

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Neni 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Neni 25, Neni 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 28, Paragrafi 1.26 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Nenit 10 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081);
- Dispozitat e Nenit 10 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes,
- Kërkesën e OSSH-së të datës 21.10.2022 për shqyrtim dhe aprovim të Planit Zhvillimor dhjetë (10) vjeçar i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes 2023 – 2032,

në seancën e mbajtur me datë 23.03.2023 nxori këtë:

## **V E N D I M**

- I. APROVOHET** - Planit Zhvillimor dhjetë (10) vjeçar i Shpërndarjes për periudhën 2023 – 2032.
- II. OBLIGOHET** – Operatori i Sistemit të Shpërndarjes KEDS SH.A, që të zbatoj projektet e planifikuara sipas këtij plani për funksionimin më të sigurt të Sistemit të Shpërndarjes.

## **A r s y e t i m**

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 21.10.2022 ka pranuar kërkesën për shqyrtim dhe aprovim të Planit Zhvillimor dhjetë (10) vjeçar të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për periudhën 2023 – 2032” të OSSH-së.
- ZRRE ka analizuar dokumenti dhe ka bërë vlerësimin e projekteve që duhet të përshihen në Planin Zhvillimor dhjetë (10) vjeçar të OSSH 2023 – 2032.
- ZRRE gjatë vlerësimit ka aplikuar një renditje prioritare të projekteve dhe programeve të bazuar në faktorët e prioritizimit të dakorduar ndërmjet OSSH dhe ZRRE.
- ZRRE pas vlerësimit të Planit Zhvillimor të njëjtin e ka hapur për diskutim publik për të pranuar



komente sugjerime dhe vlerësime si nga të licencuarat po ashta edhe nga palët e interesit.

- ZRRE gjatë periudhës së vlerësimit ka mbajtur takime të përbashkëta konsultative me OSSH-në, ku janë sqaruar apo janë marrë përgjigjet në lidhje me çështjet e ngritura.
- Pas përfundimit të konsultimit publik, dhe pas takimeve të shumta me KEDS dhe pas përfshirjes së komenteve të ZRRE-së, OSSH ka dërguar me datë 20.03.2023 dokumentin final për miratim në ZRRE.
- Bordi i ZRRE, pas vlerësimit dhe analizimit të Planit dhjetë (10) Vjeçar Zhvillimor të Shpërndarjes 2023 – 2032 ka konstatuar që janë përmbushur kërkesat ligjore, dhe ka vlerësuar se projektet e përfshira në dokument janë të arsyeshme dhe të nevojshme për funksionimin e sigurt të sistemit të shpërndarjes, prandaj ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.


III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Shtojcë: Plani Zhvillimor dhjetë (10) vjeçar i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes 2023 – 2032.**

Bordi i ZRRE-së:

  
Ymer Fejzullahu, kryesues

  
Lutfije Dervishi, anëtar

  
Gabi Buçaj, anëtar

Vendimi dhe dokumenti i dërgohet:

- Të licencuarit – KEDS SH.A, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.